



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT ANALIZË VJETORE - 2023

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), si Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri, është përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e gjithë veprimtarisë kombëtare të standardizimit, me qëllim plotësimin e nevojave të vendit për standarde teknike për të gjitha fushat e ekonomisë.

**Qëllimi** është të rrisë nivelin e sigurisë së produkteve dhe proceseve, në mbrojtje të shëndetit e jetës së personave, kafshëve si dhe mjedisit.

Sa më lart **Përafrimi i legjislacionit** kombëtar me legjislacionin evropian dhe rregulloret evropiane të standardizimit (ETSI, CEN&CENELEC) dhe ndërkombëtare (ISO dhe IEC) është ndër objektivat kryesorë të DPS. Për këtë vit DPS ka zbatuar legjislacionin ekzistues dhe e ka rishikuar të gjithë paketën ligjore për proceset e integritimit në fushën e standardizimit. Janë evidentuar të reja në këtë fushë dhe DPS ka arritur të jetë anëtare e grupit të punës për shqyrtimin dhe diskutimin e cdo iniciative/situatë dhe apo dokumenti të ri në fushën e standardizimit në nivel Evropian.

Këtë vit DPS nuk ka patur iniciativa të reja ligjore e nënligjore për fushën e saj të përgjegjësisë.

DPS ka punuar në drejtim të anëtarësimit me të drejta të plota në CEN&CENELEC dhe proceset e integritimit – screening për Kapitujt 1, 20 dhe 28 të *acquis*.

- 1. Sa i përket anëtarësimit me të drejta të plota në CEN&CENELEC DPS ka punuar për plotësimin e kriterëve dhe rekomandimeve për përmirësime, në zbatim të plan veprimit që u la nga vlerësuesit. Periudha e plotësimit/evidentimit përkundrejt plotësimit të kriterëve të anëtarësimit është lënë deri në fund të vitit 2024. Kjo periudhë i është njoftuar edhe Komisionit Evropian në takimin e 14 të Nën-Komitetit të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë për Tregëtinë, Industrinë, Doganat dhe Tatimet, mbajtur në Tiranë më 15 Nëntor 2023.**

Përmbledhja e situatës së deritanishme është si më poshtë:

No	Moskonformitetet	Afati	Ndjekja e masave të marra nga DPS
1	Kriteri - 3.3 Neutraliteti i interesave, paanshmëria dhe pavarësia e qeverisjes së anëtarëve	Tetor-2022	<b>Masat që duhen marrë:</b> DPS të zhvillojë një takim koordinues me ministritë dhe u prezantoi kërkesat që DPS duhet të plotësojë për anëtarësimin e plotë në CEN dhe CLC.  <b>E realizuar:</b> DPS, me shkresën zyrtare Nr. 191/1 Prot, datë 8.08.2022, i dërgoi një shkresë sqaruese Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MEF) në lidhje me vizitën vlerësuese, të

			<p>zhvilluar në datat 24-26 maj 2022, kundër anëtarësimit të plotë në CEN&amp;CENELEC. Kësaj letre i është bashkangjitur edhe plani i veprimit me veprime korrigjuese nga vlerësuesit.</p> <p>Gjatë takimeve me ministrinë e linjës dhe institucionet përkatëse, DPS ka shpjeguar dhe debatuar mbi kërkesat që DPS duhet të plotësojë për anëtarësimin e plotë në CEN dhe CENELEC.</p>
	<p>Kriteri - 3.3 Neutraliteti i interesave, paanshmëria dhe pavarësia e qeverisjes së anëtarëve - mungesa e kontrollit të dokumentacionit. Mirëmbajtja e certifikimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001 është thelbësore për DPS-në sepse, si një anëtar i plotë i CEN dhe CENELEC, do të duhet të demonstrojë përputhjen e sistemit me kushtet për anëtarësimin e plotë të CEN dhe CENELEC me një auditim të jashtëm dhe të pavarur.</p>	Dhjetor-2023	<p><b>Masat që duhen marrë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nevojitet rekrutim shtesë në DPS për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave, përpunimin statistikor dhe mirëmbajtjen e certifikatës ISO 9001.</li> </ul> <p><b>Puna është në vazhdim:</b></p> <p>Rekrutimi shtesë u kërkua në MFE me shkresën zyrtare të DPS-së nr. 81 prot, datë 16.03.2023 “Riorganizimi i strukturës së DPS-së në kuadër të anëtarësimit të saj në CEN&amp;CENELEC”, duke shpjeguar rëndësinë e këtij rekrutimi drejt kriterëve të anëtarësimit të plotë siç jepen në CEN&amp;CENELEC. “Shtojca D e Udhëzuesit të CEN&amp;CENELEC 22:2021” për vlerësimin e kriterëve për anëtarësim me të drejta të plota në CEN&amp;CENELEC.</p> <p>Për momentin kjo detyrë i është caktuar një specialisti të sektorit ISO/CEN në departamentin e standardeve deri në një zgjidhje më të qëndrueshme.</p>
2	<p>Kriteri - 9.2 Korniza adekuate legjislative. Ekzistenca e një komize specifike legjislative për standardizimin vullnetar, e cila të jetë plotësisht funksionale.</p>	Dhjetor-2023	<p><b>Masat që duhen marrë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>DPS do të negociojë me ministrinë që zbatimi i Direktivave të Qasjes së Re të bëhet deri në fund të vitit 2022. DPS do të negociojë me ministrinë për kornizën kohore të planit të zbatimit të Direktivave edhe të Qasjes së Vjetër. Përgatitja nga DPS të një liste të legjislacionit teknik para-ekzistues dhe referencave të standardeve (veçanërisht ekskluzive) në legjislacionin ekzistues</i></li> </ul>

			<p><b>Puna është në vazhdim:</b></p> <p>DPS ka komunikuar me ministrinë e linjës për rëndësinë e zbatimit vullnetar të standardeve në rregulloret teknike (aktet ligjore dhe nënligjore) të propozuara prej tyre dhe ka dhënë komentet dhe rekomandimet e saj për këtë qëllim, të cilat janë marrë në konsideratë.</p> <p>Për kohën e zbatimit të Direktivave të Qasjes së Re dhe të Vjetër, aktet ligjore të propozuara janë të planifikuara në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022 – 2024.</p> <p>Kjo listë do të plotësohet kur të plotësohet pozicioni vakant për informacionin në strukturën ekzistuese të DPS-së.</p>
No.	Rekomandim/Elementët me shqetësim	Afati	Ndjekja e masave të marra nga DPS
1	<p>Kriteri - 2.3 Delegacioni kombëtar;</p> <p>Kriteri - 4.1 Aktivitetet për t'iu përgjigjur nevojave të tregut, zhvillimeve teknologjike, sociale dhe ligjore;</p> <p>Kriteri - 6.3 Infrastruktura dhe burimet.</p>	Dhjetor-2024	<p><b>Masat që duhen marrë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Krijimi i një sistemi për pjesëmarrjen e ekspertëve të interesuar në zhvillimin e standardeve; akses falas në draft standardet dhe dok.e standardizimit dhe fazën e marrjes së opinionit publik - ndërhyrja, përmirësimi dhe investimi në Sistemin e Menaxhimit të Standardeve DPS (SMS).</li> </ul> <p><b>Puna në proces:</b></p> <p>Situata po vlerësohet nga ekspertët e GQSP, të cilët në bashkëpunim me AKSHI-në do të bëjnë ndërhyrjet dhe përmirësimet e nevojshme. DPS po punon që kjo të ndodhë sa më shpejt, sepse është e lidhur ngushtë edhe me realizimin e punës së përditshme të DPS për miratimin dhe publikimin e standardeve..</p>
2	Kriteri - 1.2 Puna e re Artikull	Shtator-2022	<p><b>Masat që duhen marrë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Përgatitja e procesit për zbatim Udhëzuesi CENELEC 8</li> </ul> <p><b>E realizuar.</b></p> <p>Procedura operationale e DPS-së Nr.PO/DL/209, Shtator 2022, e përgatitur dhe pjesë e dokumenteve të SMS të DPS-së.</p>
3	Kriteri - 1.5 Procedura e marrjes së opinionit publik	Korrik-2024	<p><b>Masat që duhen marrë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Informacioni për klientin se si të komentojë dhe koha për komente mbi</li> </ul>

			<p><i>draftet për opinion publik është në dispozicion përmes faqes së internetit.</i></p> <p><b>Puna në proces:</b> Kjo çështje kërkon përmirësime dhe ndërhyrje në SMS-në e DPS-së. DPS-ja nuk mund ta zgjidhë vetë, por ia ka paraqitur këtë çështje AKSHI dhe ekspertëve të Programit Global të Cilësisë dhe Standardeve (GQSP), të cilët po vlerësojnë situatën.</p> <p>DPS është në komunikim të vazhdueshëm me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe GQSP e AKSHI për këtë qëllim, si dhe për të plotësuar sa më shpejt vendin vakant të postit të IT në DPS.</p>
No.	Rekomandim/Elemente me komente	Afati	Ndjekja e masave të marra nga DPS
1	<p>Kriteri - 1.2 Puna për standardet e reja</p> <p>Kriteri - 6.1 Qëndrueshmëria financiare</p>	2022	<p><b>Masat që duhen marrë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><i>Korrigjimi në procedurat e punës dhe kryerja e auditimit financiar/Raporti i auditimit për 3 vitet e mëparshme financiare në dispozicion.</i></li> </ul> <p><b>Realizuar:</b> Të dyja këto masa janë marrë dhe realizuar brenda muajit tetor 2022 siç dëshmohet në Raportin e Auditimit, shkresa zyrtare Nr. 18972/4 Prot, datë 17.12.2022. Data e auditimit filloi në tetor 2022 me efekt që nga janari 2019 deri në nëntor 2022.</p>
	Kriteri - 6.3 Infrastruktura dhe burimet	2024	<p><b>Masat që duhen marrë:</b> <i>Sistemi i Informacionit (SMS) duhet të përmirësohet dhe duhet të krijohet një tarifë komentimi publik në dispozicion në internet për draft standardet.</i></p> <p><b>Puna në proces:</b> Ky rekomandim është nën vlerësim nga ekspertët e GQSP, të cilët në bashkëpunim me AKSHI do të bëjnë ndërhyrjet dhe përmirësimet e nevojshme. DPS është në vazhdimësi të komunikimit me GQSP dhe AKSHI për këtë qëllim.</p>
	Kriteri - 6.4 Stabiliteti	2024	<b>Masat që duhen marrë:</b>

		<p><i>Procedura e vendosur për të informuar CEN dhe CENELEC për një rregull, dispozitë ose ligj konfliktual ekzistues ose të propozuar rishitazi në nivel kombëtar.</i></p> <p><b>Puna në proces:</b> Për t'u përfunduar kur të jepet një zgjidhje e qëndrueshme në lidhje me Menaxherin e Cilësisë së DPS. Për momentin, një specialist i Departamentit të Standardeve është i ngarkuar për të kryer funksionet e Menaxherit të Cilësisë në DPS.</p>
--	--	---

2. Lidhur me proceset e integritimit – screening për Kapitujt 1, 20 dhe 28 të *acquis*, DPS gjatë takimeve të *screening* me Komisionin Evropian për këto kapituj ka prezantuar situatën e standardizimit në vend dhe planet/afatet dhe mënyrat e realizimit në të ardhmen të masave korrigjuese të lëna nga vlerësuesit. Fusha e standardizimit, duke konsideruar edhe legjislationin, i cili është në përputhje të plotë me *acquis* në këtë fushë, është konsideruar e kënaqëshme, por kërkohet më shumë suport për DPS deri në plotësimin e kriterëve dhe anëtarësimin e plotë të saj në dy organizmat evropiane të standardizimit CEN&CENELEC, si një parakusht ky për anëtarësimin e vendit në BE.

### 3. Adoptimi i standardeve evropiane e ndërkombëtare si Standarde Shqiptare (SSH)

Gjatë vitit 2023 janë adoptuar si Standarde Shqiptare (SSH); 1,792 Standarde Evropiane dhe Ndërkombëtare, duke përfshirë amendamentet dhe dokumentet e standardizimit; nga të cilat:

- 623 CEN;
- 335 CENELEC;
- 373 ETSI;
- 268 ISO;
- 193 EC.

Në total janë adoptuar 32,036 standarde Evropiane duke përfshirë Amendamentet dhe Dokumentet e Standardizimit (CEN, CENELEC dhe ETSI) si Standarde Shqiptare (SSH), nga të cilat 5,493 standarde ETSI, 8,363 CENELEC dhe 18,180 CEN; dhe 7,114 janë standarde Ndërkombëtare (ISO dhe IEC).

Origjina	SSH	SSH EN	SSH ISO+IEC	Totali
Standardet	1965	32,036	7,114	41,115

Përbërja e arkivës së Standardeve Shqiptare SSH sipas origjinës, si më poshtë:

- 18,180 CEN;
- 8,363 CENELEC;

- **5,493 ETSI;**
- **7,114 (ISO+IEC)**

Adoptimet e këtij viti sipas fushave janë si vijon:

Gjithsej, janë adoptuar rreth **1,792** standarde dhe dokumente standardizimi si Standarde Shqiptare (SSH) dhe Dokumente Standardizimi Shqiptare (DS), nga ku:

- **901** në fushën e elektroteknikës dhe telekomunikacionit - Sektori CENELEC/IEC/ETSI;
- **891** standarde nga të gjitha fushat e ekonomisë - Sektori CEN/ISO.

Pjesa më e madhe janë standarde me origjinë evropiane, rreth **1,331** standarde (CEN, CLC dhe ETSI) dhe **461** standarde ndërkombëtare (ISO dhe IEC);

**Fushat ku Komitetet Teknike kanë pasur numër më të madh adoptimesh janë si më poshtë:**

- Sporte dhe sheshe lojërash;
- Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës;
- Pajisje mbrojtëse personale;
- Sistemet e telekomunikacionit analoge dhe dixhitale;
- Pajisjet mjekësore jo aktive;
- Kimi;
- Dokumentacioni dhe informacioni;
- Informacioni dhe Teknologjia;
- Sistemet e Informacionit;
- Analizat e Produkteve Ushqimore;
- Materiale elektrike dhe elektronike;
- Plastika

Janë shfuqizuar rreth **1,035** standarde sipas fushave të caktuara dhe Komiteteve Teknike përkatëse, duke ndjekur “ciklin e jetës” së standardit.

Në mbledhjen e parë mbajtur në Shkurt 2023 Bordi Teknik i DPS **miratoi** Programin Vjetor të Punës për standardet (**2023**) dhe përbërjen e Komiteteve Teknike, për të njëjtën periudhë.

Në mbledhjen e dytë, e cila është realizuar në **Korrik 2023** shqyrtoi kërkesat e ardhura në DPS për pjesëmarrje në KT, si dhe miratoi ndryshimet në përbërjen e Komiteteve Teknike.

Ka pasur **7** kërkesa të reja për pjesëmarrje në KT të DPS-së në fushat:

- Pajisjeve matëse. Teknikat e provës dhe matjes;
- Sigurisë teknike dhe mjedisi;
- Metrologjia dhe matje;
- Siguria e Lodrave ;
- Pajisje mjekësore për diagnostikimin in vitro;
- Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës;
- Beton dhe produkte që lidhen me të. Automatizimi, menaxhimi dhe aksesorët në ndërtim;
- Analizat e produkteve ushqimore. Materialet në kontakt me ushqimin.

Gjithashtu, gjatë këtij viti DPS merr pjesë si Observer në disa Komitete Teknike (KT) të CEN dhe CENELEC si më poshtë:

- CEN/TC 176 “Metrologjia dhe matjet - Matësit e energjisë termike”
- CEN/TC 140 “Pajisje mjekësore për diagnostikimin in vitro”;
- CEN/TC 162 “Pajisje mbrojtëse personale - Veshje mbrojtëse duke përfshirë mbrojtjen e duarve dhe krahëve dhe jelekët e shpëtimit”;
- CEN/TC 264 “Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës” - Cilësia e ajrit
- CEN/TC 164 “Furnizimi me ujë”
- CLC/TC 25 “Terminologjia dhe njësitet e matjes”

Janë adoptuar **100%** standardet e harmonizuara nën Direktivat përkatëse si dhe është realizuar përditësimi dhe rifreskimi i listave të tyre nga Sekretarët e KT-ve.

Janë adoptuar rreth **92** standarde me procedurë të përsheptuar sipas kërkesave të klientëve, palëve të interesuara (biznese, institucione, laboratore, persona fizikë) kryesisht në fushat si më poshtë:

- Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës;
- Tekstile;
- Analizat e produkteve ushqimore. Materialet në kontakt me ushqimin;
- Bioteknologjia dhe Mikrobiologjia;
- Plastika;
- Teknologjia e komunikimit dhe informacionit;
- Pajisje elektrike dhe elektronike;

Janë realizuar rreth **48** Mbledhje të Komiteteve Teknike (KT) (rreth **107** Vendime adoptimi dhe rreth **50** Vendime shfuqizimi), sipas fushave të caktuara për adoptimin e standardeve dhe dokumenteve të standardizimit evropiane dhe ndërkombëtare si Standarde Shqiptare (SSH), në të gjitha fushat e ekonomisë, duke përfshirë edhe fushën e elektroteknikës dhe telekomunikacionit.

#### **4. Promovimi dhe publikimet**

Gjatë kësaj periudhe janë përkthyer dhe publikuar në faqen e ëeb-it dhe në rrjetet sociale të DPS - [DPS Facebook](#); [DPS LinkedIn](#); [DPS Tëiter](#):

- **24** Artikuj
  - **90** ekstrakte standardesh të fushave:
1. Pajisje elektroshtëpiake
  2. Pajisje inxhinierike
  3. Materiale ndërtimi
  4. Produkte ushqimore
  5. Kimia
  6. Sporti
  7. Mjekësia
  8. Siguria ushqimore
  9. Siguria e lodrave
  10. Artikuj për fëmijë
  11. Pajisje mbrojtëse personale

12. Lëndë djegëse
13. Artikuj për fëmijë
14. Pajisje për pishina
15. Sisteme alarmi
16. Trafiku rrugor
17. Turizmi
18. Materiale për paketim
19. Lëndë drusore
20. Makineri përpunimi
21. Ndriçimi
22. Makina dhe traktorë në bujqësi

Janë organizuar katër mbledhje, dy mbledhje e Bordit Teknik dhe dy mbledhje e Bordit Drejtues.

Në kuadër të kalendarit të aktiviteteve promovuese të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe në kuadër të projektit GQSP janë organizuar 4 aktivitete promovuese mbi rolin dhe rëndësinë e standardeve në infrastrukturën e cilësisë, në qytetin e Vlorës, Sarandës, Shkodrës, si dhe një aktivitet promovues mbi rolin e rëndësinë e standardeve në Bujqësi realizuar në Reç të Shkodrës.

Janë publikuar 4 Buletine informative:

<b>Buletini Informativ</b>			
<b>No</b>	<b>Periudha</b>	<b>Përmbajtja e informacionit</b>	<b>Komente</b>
93	Tetor – Dhjetor 2022	Standardet e adoptuara dhe standardet e shfuqizuara gjatë kësaj periudhe.	Buletini për këtë periudhë publikohet në ditët e para të janarit të vitit në vijim.
93/1	Janar – Dhjetor 2023 - Programi i punës për adoptimin e standardeve	Programi i punës i vitit 2023 me draft standardet shqiptare dhe draft dokumentet shqiptare për opinionin publik.	Shtojca e tij publikohet pas mbledhjes së Bordit Teknik për miratimin e Programit të Punës me Standarde.
94.	Janar – Mars 2023	Standardet e adoptuara dhe standardet e shfuqizuara gjatë kësaj periudhe.	
95.	Prill – Qershor 2023	Standardet e adoptuara dhe standardet e shfuqizuara gjatë kësaj periudhe.	
96.	Korrik - Shtator 2023	Standardet e adoptuara dhe standardet e shfuqizuara gjatë kësaj periudhe.	



--	--	--	--

## Projekti QOSP – UNIDO

Në kuadër të QOSP janë organizuar një numër takimesh dhe trajnimesh *online* dhe në zyrat e DPS. Nëpërmjet plotësimit të dy pyetsorëve mbi situatën e dixhitalizimit të proceseve të punës në fushën e standardeve është arritur të identifikohet qartë dhe të bëhet një diagnostikim i kësaj situatë. Mbas takimeve dhe diskutimeve/shpjegimeve të dhëna ekspertëve të UNIDO sëshpejti pritet të kemi draftin e parë të rekomandimeve dhe nevojave për përmirësime në databazën e standardeve.

Gjithashtu, meqenëse databaza e standardeve hostohet dhe cdo ndërhyrje apo mirëmbajtje bëhet nga AKSHI, janë zhvilluar takime në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe në AKSHI për të bërë të mundur realizimin e këtyre përmirësimeve.

Këto nevoja për përmirësime dhe ndërhyrje në databazën e standardeve përkohë edhe me zhvillimet lidhur me derregullimin e shërbimeve të ndërmarra nga Qeveria jonë. DPS është plotësisht e përfshirë në këto zhvillime, të cilat do të kenë si rezultat përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga DPS dhe plotësimin e kriterëve të anëtarësimit me të drejta të plota në CEN&CENELEC.

